VENDIM
Nr. 144, datë 22.2.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI URBAN I QYTETIT TË PUKËS"

(ndryshuar me VKM nr. 643, datë 22.11.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi urban i qytetit të Pukës".
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Pukë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë truall" dhe "objekt", me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej *69 155 766.4 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë katër)* lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej *69 155 766.4 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë katër)* lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare".
6. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Pukë.
7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Pukë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Pukë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE E PRONAVE DHE PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR OBJEKTIN: (PËR OBJEKTET E BANIMIT, SHËRBIMIT DHE TRUALLIT) QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIGJENERIMI URBAN I QENDRËS SË QYTETIT PUKË"

Nr.	EMËR MBIEMËR	Zona Kad.	NR. Pas.	Sip. e objektit të banimit (m^2)	Sip. e truallit (m^2)	Sip. e objektit të sherbimit (m^2)	Çmimi objektit të banimit (l/m^2)	Cmimi i truallit (l/m^2)	Vlera e objektit të sherbimit sipas situacionit (lekë)	Vlera e objektit të banimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	VLERA Totale e truallit, objektit të banimit dhe shërbimit (lekë)	KONFIRM ZVRPP
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	Skender Ram Zenuni	3069	46, 47			51.00			1,508,553			1,508,553	Kufizim pasurie
2	Skender Sherif Furriku	3069	45, 37		111	110.7		1620	3,433,933		179,334	3,613,267	Vërtetim hipotekor
3	Martin Frrok Prendi	3069	36			120			3,577,320			3,577,320	Vërtetim hipotekor
4	Mustaf Ram Mehaj	3069	51, 1377/1			102.9			4,441,812			4,441,812	Vërtetim hipotekor
5	Sadetet Jup Latifi	3069	22, 22/1, 73, 1392			290.4			12761228.00			12,761,228	Kufizim pasurie
6	Mendushe Isuf Hila	3069	141			28.06			1,221,250			1,221,250	Vërtetim hipotekor

7	Habibe Dem Zenuni	3069	45, 36		65	202.4		1620	7,152,206		105,251	7,257,457	Vërtetim hipotekor
8	Habibe Dem Zenuni	3069	442			88			3,322,911			3,322,911	Vërtetim hipotekor
9	Shpetim Dem Hadroj	3069	904	314.1			32,870			10,324,467		10,324,467	Vërtetim hipotekor
10	Shpetim Dem Hadroj	3069	57		51.4	102.8		1620	3,003,328		83,268	3,086,596	Kufizim pasurie
11	Mois Shaban Kuci	3069	28			30.01			1,053,667			1,053,667	Vërtetim hipotekor
12	Mark Pjeter Nikolli	3069	422	60.1			32,870			1,975,487		1,975,487	Vërtetim hipotekor
13	Hamit Osman Aliaj	3069	58,38	84.9			32,870			2,790,663		2,790,663	Vërtetim hipotekor
14	Rasim Elez Hoxha	3069	63	60.1			32,870			1,975,487		1,975,487	Vërtetim hipotekor
15	Mark Mirash Gjergji	3069	812	60.1			32,870			1,975,487		1,975,487	Vërtetim hipotekor
16	Drane Pjeter Mema	3069	19, 39	84.9			32,870			2,790,663		2,790,663	Vërtetim hipotekor
17	Adriana Muhamet Barxhani	3069	44	60.1			32,870			1,975,487		1,975,487	Vërtetim hipotekor
18	Mustaf Ram Mehaj	3069	1255	60.1			32,870			1,975,487		1,975,487	Vërtetim hipotekor
											Shuma	67,627,289.4	

(shtuar me VKM nr. 643, datë 22.11.2023)

LISTA EMËRORE E PRONARIT, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILIT PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 144, DATË 22.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'RIKUALIFIKIMI URBAN I QYTETIT TË PUKËS"'

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: "Ndërtesë"										
Nr.	**TË DHËNAT E PRONËS**									
	Emri	**Atësia**	**Mbiemri**	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Sip. totale e objektit të shpronësuar m²**	**Sip. që shpronësohet e objektit m²**	**Vlera e objektit me situacion lekë**	**Shënime**
19	Gezim Mustaf Kurtalia			3069	1/42 2-N	Njësi	54.72	54.72	**1,528,477**	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Pukë
Sipërfaqe totale shpronësimi m²								**54.72**		
Vlera totale e shpronësimit në lekë									**1,528,477**	

Shënime 1. Për objektin e llojit "njësi", vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar.